



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:163603

Datë: 05.12.2024

Numri i dokumentit: 06554968

P.nr.76/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Fatmir Krasniqi me bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit **A. M. nga fshati...**, Komuna e Dragashit, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas Propozimit të prokurorit të shtetit në Prizren për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshem psikiatrik në liri, PP.nr.1457-1/2021 të dt. 06.11.2024, në seancën e shqyrtimit gjyqësor në prezencën e paleve, Prokurorit të shtetit Elfete Purova, të akuzuarit **A. M. dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare av. A. R.**, me datë 15.11.2024 mori ndërsa me dt. 04.12.2024 përpiloi edhe këtë:

A K T V E N D I M

Ndaj të pandehurit:

A. M., nga i ati **A.**, e ëma **H.**, i lindur me dt... në fsh..., Komuna e Dragashit, ka të kryer fakultetin, pensioner, i martuar, babai i 5 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës me numer personal...

P E R S H K A K

Më datë 23.07.2021, rreth orës 05:40 minuta, në fshatin **K.** të Komunës së Dragashit, me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore të dëmtuarit **I. M.**, në atë mënyrë që derisa i dëmtuari po flinte në dhomën e tij, në shtëpinë e përbashkët me të akuzuarin, të cilin e ka baba, i pandehuri me mjet të rrezikshëm që mundë të shkaktoj lëndim të rëndë trupor, respektivisht me mjetin e mprehtë – sopatë, e dëmton derën e dhomës së fjetjes ku ishte i dëmtuari, me sopatë e godet të dëmtuarin i cili nga frika se do ta gjejë diçka edhe më keq nga frika ikë nga shtëpia, ndërsa të dëmtuarit i shkakton lëndime të lehta trupore të cilat lëndime paraqesin gërvishje në anën e majtë të kraharorit, me pasoj të dëmtimit të përkohshëm të shëndetit, të konstatuar si në akt ekspertimin mjeko ligjor, me numër të lëndës 0047846, të konstatuar nga eksperti mjeko ligjor Prof. As. Dr. F. B., me datë 26.07.2021.

- Me këto veprime në gjendje të paaftësisë mendore ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Prandaj gjykata ne kuptim te nenit 84, nenit 86 par.1 nenpar. 1.2, të KP-ës e lidhur me nenin 512 par. 2 dhe 514 par.3 p.3.1, 3.2,3.3 te KPPK-es, ndaj te pandehurit i:

SH Q I P T O N

MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKIATRIK NË LIRI

1.Masa do të filloj të zbatohet menjëherë dhe i pandehuri do të paraqitet në Qendrën e Shëndetit Mendor në Prizren (në rast të mosparaqitjes vullnetare të të pandehurit pranë Qendrës së Shëndetit Mendor në Prizren, konform udhëzimeve të Qendrës obligohet që trajtimin ta kryej në shtëpi të të pandehurit apo edhe detyrimisht ta dërgoj në repartin e Psikiatrisë pranë Spitalit Regional në Prizren).

2.Qendra e shendetit mendor obligohet qe ta trajtoj ne pikepamje mendore – psikiatrike te pandehurin A. M. duke e udhezuar per periudhat e sakta ne te cilat duhet te paraqitet në trajtim.

3.Qendra e shendetit mendor ne Prizren obligohet që në periudha 3 mujore ta njoftoje me raport te veçant Gjykatën Themelore ne Prizren – Dega në Dragash – Departamentin e Pergjithshem Penal, per ecurin e trajtimit te obligueshem psikiatrik të A. M. dhe nese eventualisht ka nevojë që të ndërrohet masa ose e njejta të ndërprehet.

4.Masen e shqiptuar si nen pikën 1. te ketij aktvendimi, gjykata do ta pushojë kur të verteton se ka pushuar nevoja per trajtim ne institucionin e shendetit mendor ne Prizren.

5.Shpenzimet e procedures penale bien në barr të mjeteve buxhetore te kesaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Prizren i ka parashtruar Gjykates Themelore ne Prizren – Dega në Dragash Propozim per shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshem psikiatrik në liri me numer, PP.nr.1457-1/2021 te dt.06.11.2024 ndaj të akuzuarit A. M. nga fshati..., Komuna e Dragashit, per shkak se ka kryer veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par. 1 të KP-së.

Gjykata para filimit te shqyrtimit gjyqesor merr mendimin e ekspertit te psikiatrisë - forenzika psikiatrike në QKU-në Prishtenë Dr. J. Z. mbi gjendjen shendetësore se a mund ta perballoj shqyrtimin gjyqesor, ku eksperti i psikiatrise Dr.J. Z. njofton gjykatën se i akuzuari A. M. në rastin konkret mund ta perballoj shqyrtimin gjyqesor por të dhënat mund të jenë të shtrembëruara apo dëmtuara për shkak të natyrës së sëmundjes së tij, dhe i njejtë deklaroi: pas shqyrtimit te dokumentacionit mjekësor dhe pasi që është ekzaminuar i pandehuri A. M. nga ne si ekip, kemi konstatuar qe i ekzaminuari ynë vuan nga çrregullimi akut psikotik çrregullim ky që në klasifikimin ndërkombëtar e sëmundjeve kodohet me F23.8. Ky çrregullim është akut me një gjendje psikiatrike përfshirë paraqitjen e pa prititur të simptomave psikiatrikë të cilat zgjasin një muaj e më shumë ditë. Përmirësimi është i plot nëse këta klient e përdorin terapinë e përshkruar më rregull nga ana e psikiatrit. Simptomotologjia përfshin deluzionet - bindjet qe mund të jetë të persekutimit, përndjekjes dhe raportit, të folurit të çrregullohet dhe të manifestuara më sjellje impulsive në rrethi primarë. Sa i për këtë ditës kritike 23.07.2021 në momentin e kryerjes së veprës penale për të cilën ngarkohet për shkak të specifikave të sëmundjes ka ardhur deri te përkeqësimi i sëmundjes bazë andaj aftësia e tij mendore për të kuptuar rrëndësin e veprës si dhe kontrollin e veprimet e veta kanë qen e përjashtuara si në raportin me shkrim të dt. 24.08.2021 dhe të dt. 27.08.2021.

Gjykata ne shqyrtimin gjyqesor në fjalën perfundimtare Prokurori Themelor i shtetit ka deklaruar: pas konstatimeve të ekspertit të psikiatrisë të dhena ne kete shqyrtim, si dhe propozimeve të ekspertit se ketu i pandehuri duhet te trajtohet ne institutin e psikiatrise forenzike dhe se tere kjo eshte ne interes te te pandehurit, dhe njeherit ne tersi qendron prane mendimit te ketu ekspertit te forenzikes psikiatrike Dr. V. B.-R. – psikiatër forenzik, Dr. J. Z. – psikiatër forenzik dhe Dr.Sh. H., psikiatër, duke e mbeshtetur te njejtin mendim që ndaj te pandehurit A. M. ti shqiptohet masa masa e trajtimit te detyrueshem psikiatrik ne liri.

Mbrojtësi i të pandehurit av. A. R. në lidhje me kërkesën për caktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri deklaroi: Nuk e kundërshtojmë ekspertizën e ekspertit të forenzikës dhe pajtohet në tërësi me deklaratën e tij Dr. J. Z. dhe njëherë nuk kam pyetje, meqenëse është evidente nevoja për trajtim për të mbrojtur tim konsiderojmë se ndaj të mbrojturit tim të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri.

Gjykata ne shqyrtim gjyqesor kryesor, perkitazi me aktakuzen dhe propozimin e prokurorit te prokurorise themelore te shtetit, degjoi ekspertin e psikiatrise forenzike Dr.J. Z. psikiater, lexoi ekspertizen psikiatrike te psikiatrit Dr. V. B.-R. – psikiatër forenzik, Dr. Je. Z. – psikiatër forenzik dhe Dr. Sh. H., psikiatër, beri shqimin e fotodokumentacionit, dhe te shkresave të lendes, nga të gjitha keto prova, si dhe nga deklarata e pandehurit A. M. ku gjykata i vleresoi të gjitha keto prove veq e veq dhe nderlidhje në bazë të vleresimit te ketillë konstatoi: Se i pandehuri A. M. është person me gjendje te paaftësisë mendore, nga se është fjala për një semundje çrregullim akut psikotik, çrregullim që në klasifikimin ndërkombëtar është e koduar me cifren F23.8, ky ç'rregullim kryesisht karakterizohet me deluzione – bindje që mund të jetë të përsekutimit, përndjekjes dhe raportit, të folurit të çrregulluar dhe të manifestuar me sjellje impulsive në rrethin primar. Per sa i perket veprave penale per te cilen akuzohet, aftesia e tij mendore e të kuptuarit dhe kontrollit te veprimeve te veta ne momentin e kryerjes se veprave penale, llogaritshmeria ka qenë e përjashtuar dhe i akuzuari rekomandohet qe të ketë trajtim te vazhdueshem psikiatrik në liri në spitalin mendor shendetësor në Prizren.

Nga provat dhe faktet e vertetuara ne kete çeshtje penale, ne favor te kesaj gjendje me se miri deshmonë fakti në deklarimin ne shqyrtimin gjyqesor te ekspertit te forenzikes psikiatrike, ekspertiza e forenzikes-psikiatrike ne emer te A. M. prandaj duke marre parasysh te gjitha faktet vendimtare te vertetuara mirë, me padyshim me anë te provave gjykata konkludon se i pandehuri A. M. nuk është përgjegjes i veprës penale te më lartë cekur, të pershkruar si në shqiptim të këtij aktvendimi, se në kohen e kryerjes se veprës penale llogaritshmeria ka qenë e përjashtuar, duke mos mundur ti kuptoj veprimet e tija, se është person me pergjegjesi të përjashtuar, andaj nëse i njejt i lihet pa perdorim te terapise psikiatrike-barnave, mund të ekzistojë rreziku se mund te kryej veper penale te re, per shkak te kesaj, sipas ekspertit psikiatrik, po të lihet pa kujdes dhe terapi mjekesor, i njejt mund të perserisë situata te tilla të dhunshme të cilat paraqesin rrezik per vehten dhe per të tjerët, prandaj gjykata aprovoi propozimin e ekspertit të forenzikes psikiatrike dhe prokurorit të shtetit për caktimin e mases së obligueshme te trajtimit te detyrueshem psikiatrik ne liri per të pandehurin A. M. në mbeshtetje te nenit 86 te KPK-es dhe nenit 514 par.1 p.3 te KPPK-ës.

Meqenese i pandehuri nuk eshte shpallur fajtor, lidhur me shpenzimet procedurale eshte vendosur se te njejtat bien ne buxhetin e kesaj gjykate, konform nenit 454 par.1 te KPP-se.

Me sa u tha me larte, u vendos si ne shqiptim te ketij aktvendimi

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2021:163603, 15.11.2024

Gj y q t a r i,

Fatmir Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 8 dite, pas ditës së pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.